



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivered	05-01-2024	4	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot B: Prot Prot No	Shloja a Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SADMSTHCK	61/2024		114



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1473/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Jeton Koca - kryetar, Ardita Haxhnikaj - Demi dhe Eshref Shaban - anëtarë, me Avdyl Bekteshi - Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1473/2023 të datës 04.12.2023 të parashtruar nga nga Prishtina, kundër organit të punësimit/Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në çështjen juridike "Kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 05.01.2024, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprobhet si e bazuar ankesa A.nr.1473/2023 e datës 04.12.2023 e parashtruar nga ankuesi

II. Detyrohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimi të këtij vendimi, të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e Vendimit Nr.1517/2023 të datës 08.11.2023, lidhur me kompensimin për funksionin shtesë për ankuesin si në pikën 1 të këtij Vendimi.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë Vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi) i punësuar në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, më datë 04.12.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 7209/2023 të regjistruar nën shenjen A.nr.1473/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër organit të punësimit/ Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për shkak të mos zbatimit të Vendimit Nr.1517/2023 të datës 08.11.2023, lidhur me kompensimin për funksione shtesë sikurse përcaktohet me Rregulloren (QRK) Nr.10/2023 për Kompensimin për Funksionin Shtesë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 06.12.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ndërsa kjo e fundit, më datë 18.12.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me provat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm: Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën me numër protokoll 7209/2023 të datës 04.12.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për pagesë të datës 11.09.2023; Formularin e certifikimit të dokumentacionit të datës 15.11.2023; Urdhër obligimi për pagesë të datës 13.11.2023; Urdhrin për blerje të datës 14.11.2023; Vendimin Nr.1517/2023 të datës 08.11.2023; Kërkesën për kompensimin e anëtarëve të brendshëm të Komitetit të Auditimit të Brendshëm të datës 07.11.2023; Vendimin Nr.1050/2020 të datës 23.10.2020 për emërimin e Komitetit të Auditimit në MKRS; Procesverbalin nga mbledhja e Komitetit të Auditimit të Brendshëm të datës: 20.03.2023, 01.06.2023, 14.08.2023, dhe 10.10.2023; Dokumentin e identifikimit të ankuesit; E-mailin e datës 05.11.2023 nga Xh.K; E-mailin e datës 03.11.2023 nga ankuesi për F.H; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 06.12.2023; Përgjigjen në ankesë të datës 18.12.2023; Akt Emërimit të datës 20.01.2012; Përshkrimin e detyrave të punës të datës 26.03.2013; E-mailin e datës 29.12.2023 nga A.B për T.B; E-mailin e datës 29.12.2023 nga L.B për T.S; E-mailin e datës 02.01.2024 nga T.S për L.B dhe Emailin e datës 03.01.2024 nga L.B për A.B. Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç, si dhe në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është e bazuar, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesi sipas Akt Emërimit të datës 20.01.2012 është i emëruar në pozitën e punës *Shef i Arkivit* në Departamentin e Administratës Qendrore në kuadër të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (në tekstin e mëtejshëm: MRKS).

Udhëheqësi me i lartë administrativ i organit përkatës të punësimit, respektivisht Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të MRKS-së, me Vendimin Nr.1050/2020 të datës 23.10.2020, ka emëruar Komitetin e Auditimit të Brendshëm në MRKS, në përbërje, prej: në MASHT-kryesuese; në MD-anëtar dhe në MKRS-anëtar. Si rrjedhojë, drejtori i Njësisë së Auditimit të Brendshëm, më datë 07.11.2023 ka parashtruar kërkesë tek udhëheqësi me i lartë administrativ, për kompensimin e ankuesit si rezultat i angazhimit në Komitetin e Auditimit të Brendshëm. Ky i fundit, më datë 08.11.2023 me Vendimin Nr.1517/2023 ka miratuar Kërkesën e datës 07.11.2023 dhe si rrjedhojë ia ka njohur të drejtën ankuesit për kompensim në emër të funksionit shtesë për takimet e mbajtura në muajin: mars, maj, gusht, si dhe muajin tetor të vitit 2023, mirëpo nga analizimi i shkresave të lëndës rezulton se ky vendim nuk është zbatuar nga organi përkatës i punësimit.

Ankuesi në ankesën e parashtruar me datë 04.12.2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se e drejta e kompensimit i është njohur sipas Vendimit Nr.1517/2023 të datës 08.11.2023, mirëpo lënda nuk është certifikuar nga zyrtari përgjegjës me arsyetimin se, kompensimi i të emëruarve në borde dhe komisione bëhet vetë nëse janë emëruar me vendim të ministrit.

Kolegji i Këshillit, duke vepruar sipas autorizimeve kushtetues dhe ligjore për mbikëqyrjen e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, si dhe në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit lidhur me detyrimin e organit përkatës të punësimit për zbatimin e Vendimit Nr.1517/2023 të datës 08.11.2023, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, respektivisht:

Nenit 35 ku përcaktohet se: 1. Kompensimet që mund të përfitohen në bazë të këtij ligji janë: 1.1. kompensimi për kujdestari; 1.2. kompensimi për punë gjatë natës dhe jashtë orarit të punës; 1.3. kompensimi për punë gjatë fundjavës dhe ditëve të festave zyrtare; 1.4. kompensimi për udhëtime dhe shpenzimet e

përfaqësimit; 1.5. kompensimi për funksionin shtesë; 1.6. kompensimi për anëtarët/ët e shërbimit të jashtëm; dhe 1.7. kompensimi për stafin tjetër të administratës që punojnë jashtë vendit.

Nenit 38 ku përcaktohet se: 1. Kur zyrtaret/ët publik, sipas legjislacionit në fuqi emërohen/caktohen që të shërbejnë në një bord, komision profesional apo organ tjetër publik që kërkon ekspertizë profesionale dhe përbën funksion shtesë për zyrtaren/in, ky/kjo zyrtar/e publik/e ka të drejtën e kompensimit shtesë për këtë funksion. 2. Kompensimi sipas pikës 1. të këtij neni nuk nënkupton detyrat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga pozita të cilën e mban zyrtarja/i publike, përfshirë këtu edhe pjesëmarrjen në komisione dhe/apo organe të tjera të themeluara brenda institucionit. 3. Kompensimi sipas këtij neni bëhet në masën tridhjetë për qind (30%) për kryetaren/in dhe njëzet për qind (20%) për anëtarët/ët, të pagës bazë së zyrtares/it kryesor administrativ të institucionit në të cilën themelohet bordi, komisioni profesional apo organi tjetër publik. 4. Kompensimi i parashikuar në këtë nen, në rastin kur bordi, komisioni profesional apo organi tjetër publik mblidhet së paku një (1) herë në muaj, përfitohet çdo muaj, me kusht pjesëmarrje në mbledhje. 5. Kompensimi i parashikuar në këtë nen, në rastin kur bordi, komisioni profesional apo organi tjetër publik mblidhet më rrallë se një (1) herë në muaj, kompensimi përfitohet për çdo mbledhje, me kusht pjesëmarrje në mbledhje. 6. Qeveria, me propozim të ministrisë përgjegjëse për administratë publike dhe pas pëlqimit nga ministria përgjegjëse për financa, me akt nënligjor miraton kriteret për përfitim të këtij kompensimi.

Po ashtu, në lidhje me këtë çështje ju referua edhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr.10/2023 për Kompensimin për Funksione Shtesë, përkatësisht nenit 4 ku përcaktohet se: 1. Zyrtari publik i cili emërohet/caktohet që të shërbejnë në një bord, komision profesional apo organ tjetër publik që kërkon ekspertizë profesionale dhe përbën funksion shtesë për këtë funksion. 2. Kompensimi sipas pikës 1 të këtij neni nuk nënkupton detyrat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga pozita të cilën e mban zyrtari publik, përfshirë këtu edhe pjesëmarrjen në komisione dhe/apo organe të tjera të themeluara brenda institucionit..." Nenin 5 paragrafi 2 ku parashihet se: 2. Përfshirë, kompensimi për funksionin shtesë mund të përfitohet kur plotësohen në mënyrë kumulative kriteret e mëposhtme: 2.1. themelimi i Komisionit/Bordit parashihet në ligj apo akt nënligjor; 2.2. përfshirja në komision përbën funksion shtesë për zyrtarin publik; 2.3. funksioni nuk bënë pjesë tek detyrat e obligueshme të pozitës të cilën zyrtari publik e mbanë; 2.4. përfshirja në Komision kërkon ekspertizë profesionale të cilën zyrtari e posedon; 2.5. komisionet/bordet të cilat kanë kompetenca Vendim-marrëse në procedurë administrative; 2.6. komisioni/bordi nuk themelohet nga institucioni ku zyrtari publik është i punësuar..." si dhe nenin 7 ku përcaktohet se: 1. Kompensimi sipas këtij neni bëhet në masën tridhjetë për qind (30%) për kryetarin dhe njëzet për qind (20%) për anëtarët, të pagës bazë së zyrtarit kryesor administrativ të institucionit në të cilën themelohet bordi, komisioni profesional apo organi tjetër publik. 2. Kompensimi i parashikuar në këtë nen, në rastin kur bordi, komisioni profesional apo organi tjetër publik mblidhet së paku një (1) herë në muaj, përfitohet çdo muaj, me kusht pjesëmarrje në mbledhje. 3. Kompensimi i parashikuar në këtë nen, në rastin kur bordi, komisioni profesional apo organi tjetër publik mblidhet më rrallë se një (1) herë në muaj, kompensimi përfitohet për çdo mbledhje, me kusht pjesëmarrje në mbledhje.

Bazuar në kuadrin ligjor si me lartë dhe në mbështetje të provave materiale të çështjes, Kolegji i Këshillit konstatoi se pretendimet ankimore të ankuesit për kompensimin e tij në emër të funksionit shtesë, janë të bazuara për faktin se në rastin konkret janë plotësuar në mënyrë kumulative kërkesat e përcaktuara sipas dispozitave që rregullojnë çështjen e kompensimit për funksione shtesë, ngase, Kolegji i Këshillit ka gjetur se themelimi i Komitetit të Auditimit të Brendshëm është përcaktuar me akt të veçantë, respektivisht me nenin 6 të Ligji Nr.03/L-128 për Auditimin e Brendshëm, dhe se organi përkatës i punësimit në mbështetje të kësaj baze ligjore me Vendimin Nr.1050/2020 të datës 23.10.2020, ka themeluar Komitetin e Auditimit të Brendshëm në MRKS, ku bënë pjesë edhe ankuesi. Po ashtu, përfshirja e ankuesit në këtë komitet padyshim se përbën funksion shtesë sepse nga analizimi i përshkrimit të detyrave të punës, rezulton se



funkcioni në të cilin është caktuar i njëjti nuk benë pjesë tek detyrat e obligueshme të pozitës të cilën e mban ankuesi si Shef i Arkivit. Rrjedhimisht, organi i punësimit me vet faktin se ka caktuar ankuesin në Komitetin e Auditimit të Brendshëm e ka vlerësuar paraprakisht ekspertizën profesionale të cilën zyrtari e posedon. Kolegji i Këshillit ketë konstatim e mbështeti po ashtu edhe në Qarkoren Administrative me numër reference 355 të datës 22.03.2023 të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme lidhur me zbatimin e Rregullores (QRK) Nr.10/2023 për Kompensimin për Funkcionin Shtesë, përkatësisht nenin 8 ku përcaktohet se: *8. Në rastet kur përbërja e Komisioni/Bordi është nga institucione të ndryshme, kryesuesi dhe të gjithë anëtarët e Komisionit/Bordit kanë të drejtë të kompensohen, duke përfshirë edhe anëtarët të cilët janë të punësuar në institucionin që ka nxjerrë vendimin për themelimin e Komisionit/Bordit. Kjo vlen për Komisione/Borde që janë tërësisht ndryshe nga përshkrimi i detyrave të punës - si p.sh Komiteti i Auditimit të Brendshëm, Komisioni për Vlerësim të Dëmeve të Shkaktuara nga Fatkeqësitë Natyrore, Komisionet e ndryshme të themeluara nga Qeveria me përbërje të Institucioneve tjera.*

Andaj, për sa me sipër Kolegji i Këshillit vlerëson se Vendimi Nr.1517/2023 i datës 08.11.2023 i zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm për aprovimin e Kërkesës të datës 07.11.2023 për lejimin e kompensimit në emër të funksionit shtese për ankuesin është në pajtueshmëri me dispozitat e ligjit material, gjegjësisht nenin 35 dhe 38 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nenin 4, 5 dhe 7 të Rregullores (QRK) Nr.10/2023 për Kompensimin për Funksione Shtesë, si dhe nenin 8 të Qarkores Administrative me numër reference 355 të datës 22.03.2023 të Ministrisë se Punëve të Brendshme lidhur me zbatimin e Rregullores (QRK) Nr.10/2023 për Kompensimin për Funkcionin Shtesë, dhe si rrjedhojë në ketë kuptim edhe pretendimi ankimor i ankuesit për detyrimin e organit përkatës të punësimit për zbatimin e Vendimit Nr.1517/2023 të datës 08.11.2023 është i bazuar.

Kështu që në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi që të aprovoj në tërësi si të bazuar aneksen e ankuesit, dhe të obligoj Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturë, Rinisë dhe Sportit, që të ndër marr veprimet e nevojshme për zbatimin e Vendimit me Nr. 1517/2023 të datës 08.11.2023, lidhur me kompensimin për funksionin shtesë për ankuesin, sikurse është përcaktuar në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1473/2023

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



I dërgohet:

- Ankuesit;
- Sekretarit të Përgjithshëm të MKRS-së;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në MKRS;
- Arkivit të KPMSHCK-së.